



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Legjislatura e III-të

Nr. 08/08

Prishtinë, më 23.04.2008, ora 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL

nga mbledhja e Komisionit për Buxhet dhe Financa

Anëtarët e pranishëm të Komisionit: Gani Koci, Haki Shatri, Kosara Nikolić, Hajdin Abazi, Armend Zemaj, Myrvete Pantina, Xhevdet Neziraj, Besa Gaxherri, Müfera Şinik, Shkumbin Demaliaj.

Anëtarët jo të pranishëm: Behxhet Pacolli, Safete Hadërgjonaj.

Të ftuar: Ilhami Gashi dhe Ramë Qupeva nga Ministria për Transport Postë dhe Telekomunikacion.

Nga shërbimi i sekretarisë: Natasha Tisma-Prica, Arta Hajra, Vilson Ukaj, Dashurie Canolli.

Gjithashtu të pranishëm ishin: Richard Collins nga Zyra e Ambasades Amerikane në Prishtinë-Këshilltar vendor, Departamenti i Thesarit të SHBA-ve, monituroes nga ZKM, OSCE, KDI, NDI, ZPK.

Kryesues: Gani Koci, kryetar i komisionit

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 3. Shqyrtimi i Propozim vendimit të Qeverisë për shpalljen e hapësirës-trasesë zonë me interes të veçantë publik në Kosovë për ndërtimin e Autoudhës Morinë-Merdarë dhe**

Prishtinë – Hani i Elezit me përfundimin nr.03-0304/DO-146 dt.1.04.2008 të Kryesisë së Kuvendit

Të ftuar:

Përfaqësues të Ministrisë së Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit;

- 4. Shqyrtimi i Projektligjit për parandalimin e pastrimit të parave me komentet e Ambasadës Amerikane në Prishtinë;**
- 5. Shqyrtimi i Projektligjit për përfitimet e ish zyrtarëve të lartë me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, me amendamente;**
- 6. Shqyrtimi i Projektligjit për deklarimin dhe prejardhjen e pasurisë së zyrtarëve të lartë publik me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, me amendamente;**
- 7. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin Ekzekutimin e Sanksioneve Penale me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, me amendamente;**
- 8. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, me amendamente;**
- 9. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 03/L-18 për Provimin përfundimtar dhe të maturës me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sporte, me amendamente;**
- 10. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari hapi mbledhjen, përshëndeti pjesëmarrësit për praninë e tyre dhe prezantoi rendin e ditës.

Rendi i ditës u miratua si i tillë i propozuar.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

Procesverbali nga mbledhja e kaluar dt. 11.04.2008, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Propozim vendimit të Qeverisë për shpalljen e hapësirës-trasesë zonë me interes të veçantë publik në Kosovë për ndërtimin e Autoudhës Morinë-Merdarë dhe Prishtinë – Hani i Elezit me përfundimin nr.03-0304/DO-146 dt.1.04.2008 të Kryesisë së Kuvendit

Të ftuar: Përfaqësues të Ministrisë së Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit

Kryetari vlerësoi iniciativën e Ministrisë për të kërkuar pëlqimin e Komisionit dhe vendimin e Kuvendit që pjesët e vendit në të cilat kalojnë autoudhat të shpallen zona me interes të veçantë publik. Rreth shpronësimit të pronave, kërkoi sqarime se a janë marrë parasysh kufijtë buxhetor për shpronësim.

Ilhami Gashi theksoi se në kuadër të aktiviteteve prioritare për ndërtimin dhe modernizimin e infrastrukturës rrugore si shtyllë themelore e zhvillimit ekonomik, MTPT i ka të gatshme edhe projektet për ndërtimin e Autoudhës Morinë-Merdarë dhe Prishtinë-Hani i Elezit. Projektet janë punuar nga viti 2004 dhe tanimë janë të kompletuara dhe Ministria është e përgatitur të fillojë punën për ndërtimin e tyre. Prandaj kërkohet nga Komisioni juaj dhe Kuvendi të merr vendim që këto pjesë në të cilat kalojnë Autoudhat të shpallen zona me interes të veçantë publik në mënyrë që të krijohet infrastruktura ligjore për fillimin e punimeve. Projekti është mjaftë i detalizuar, janë krijuar komisionet për eksproprijim që përbëhen nga ekspertët e MTPT, Ministrisë së Ambientit dhe

ekspertët nga Komunitat përkatëse. Incizimet kadastrale janë bërë, do të identifikohen pronarët dhe shpronësimi do të bëhet konform ligjit që përcakton çmimin e vlerës së tregut. Ndërtimi i këtyre rrugëve do të mundësojë lidhjen më të mirë të vendit tonë me Shkupin dhe me Portin e Durrësit e nëpërmes tyre edhe me vendet e Evropës Juglindore, kjo do të i hap perspektivat për zhvillimin më të shpejtë ekonomik të Kosovës.

Haki Shatri theksoi se është mirë i informuar me projektet dhe vlerëson rëndësinë e realizimit sa më të shpejtë të tyre. Kërkoj edhe nga anëtarët tjerë që ta mbështesin këtë kërkesës dhe të i rekomandohet Kuvendit që në ato pjesë ku do të ndërtohen rrugët të shpallen zona më interes të veçantë publik. Pyeti përfaqësuesit e Ministrisë, pse nuk është kërkuar edhe në pjesën ku do të ndërtohet rruga Prishtinë-Pejë që të shpallet zonë më interes të veçantë publik. Në këtë kontekst sugjeroi Ministrinë që për të gjitha projektet rreth ndërtimit të rrugëve të kërkoj nga Kuvendi të nxjerr vendim, që ato pjesë të shpallen zona më interes të veçantë publik, pavarësisht se kur do të fillojnë punimet në ato rrugë.

Xhevdet Neziraj përkrahu projektin si të tillë dhe kërkesën për shpallje si zonë më interes të veçantë publik. Lidhur me shpronësimin dhe kompensimin e pronarëve, kërkoj që të bëhet konform ligjit dhe në bazë të çmimit të tregut para fillimit të ndërtimit të autoudhëve në mënyrë që mos të paraqiten problemet e kompensimit të këtyre pronarëve.

Armend Zemaj vlerësoi rëndësinë e projektit dhe bëri një pyetje: sa keni punuar dhe se keni pasur sukses që pronat shoqërore-private nëpër të cilat do të kalojnë autoudhat që të mos privatizohen apo edhe të mos ndërtohet asgjë.

Myrvete Pantina vlerësoi rëndësinë e projekteve për ndërtimin e këtyre rrugëve, të cilat do të hapin perspektiva për integritet rajonale. Znj.Pantina u interesua rreth burimit të financimit të projekteve, përveç mundësisë së shfrytëzimit të mjeteve nga licencimi i telefonisë së dytë mobile a do të merren edhe mjetet nga privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore për realizimin e këtyre projekteve.

Shkumbin Demaliaj theksoi nga shqetësimet e qytetarëve dhe nga përditshmëria vërehet se ka probleme në qarkullimin rrugor, sidomos me kalimin e këmbësorëve të cilët rrezikojnë jetën e tyre dhe në të njëjtën kohë pengojnë komunikacionin. Lidhur me udhëkryqin e Fushë Kosovës pyeti se a është paraparë ndonjë metro për kalim të këmbësorëve apo ndonjë zgjidhje tjetër në mënyrë që mos të pengohet autoudha.

Hajdin Abazi vlerësoi shumë strategjike dhe afatgjate ndërtimin e autoudhës Prishtinë-Hani i Lezit, si një rrugë urbane dhe moderne. Pyeti se sa do të jetë e gjerë zona me interes të veçantë publik, a do të jetë vetëm rruga apo edhe pjesët tjera përcjellëse të rrugës.

Ramë Qupeva lidhur me autoudhën Prishtinë-Han i Elezit të gjitha përgatitjet janë bërë. Përparësi e saj është se vijat egzistojnë dhe kjo do të ndihmojë në ndërtimin e rrugës së re. Por problemi më i madh paraqet shpronësimi i ndërtimeve ilegale dhe të uzurpuara. Lidhur me autoudhën Prishtinë-Pejë, vlerësoi rëndësinë e ndërtimit të saj por për shkak të mungesës së një vije të qartë kjo do të ndodh më vonë. Në pyetjen e z.Demaliaj rreth udhëkryqit të F.Kosvës theksoi se janë në fazën e projektimit dhe parashihet që të ndërtohet një rrethrotullim në dy nivele, në këtë mënyrë do të zgjidhet problemi i këmbësorëve. Ndërsa lidhur me pyetjen e z.Abazi theksoi se është planifikuar që të shpallet zonë me interes të veçantë edhe pjesa përcjellëse ku parashihen ndërtimi i objekteve,si: pompa benzine, objekte gazsjellësit, naftësjellësit, hotele, etj.

Kryetari kërkoj nga anëtarët të mbështesin këtë kërkesës dhe komisioni t'i rekomandojë Kuvendit për këtë pjesë dhe për pjesët tjera ku parashihet ndërtimi i rrugëve në territorin e Kosovës t'i shpall

zona me interes të veçantë publik, në mënyrë që të krijohen kushtet për fillimin e punëve nga Ministria konform ligjit dhe procedurave të shpronësimit.

Pas vërejtjeve të bëra, me votimin e bërë Komisioni njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I. Komisioni për Buxhet dhe Financa shqyrtoi Propozim vendimin e Qeverisë për shpalljen e hapësirës-trasesë zonë me interes të veçantë publik në Kosovë për ndërtimin e Autoudhës Morinë-Merdarë dhe Prishtinë-Han i Elezit dhe miratoi të njëjtin me konstatimin se një vendim i tillë është i një interesi të veçantë nacional për Kosovën dhe i rekomandon Kuvendit që në procedurë të mëtejme ta miratojë atë.
- II. Sipas kësaj, Komisioni për Buxhet dhe Financa rekomandon që Qeveria me rastin e hartimit të Projekteve të strategjisë nacionale në Kosovë, para fillimit të implementimit të njëjtëve, t'i propozoj Kuvendit shpalljen e hapësirave të tilla zona të interesit të veçantë publik.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për parandalimin e pastrimit të parave me komentet e Ambasadës Amerikane në Prishtinë

Kryetari falënderoi z. Collins për ndihmën dhe komentet e tij lidhur me Projektligjin për parandalimin e pastrimit të parave. Njoftoi atë se Projektligji në fjalë është në shqyrtim nga Komisioni që dy vite, në përgatitjen e tij kanë marrë pjesë ekspertë nga fusha penalo-juridike të cilët në bashkëpunim me anëtarët e komisionit kanë përgatitur amendamentet por nuk ka kaluar për shqyrtim të dytë sepse ishte finalizuar në kohë e përfundimit të legjislaturës së II dhe mbajtjes së zgjedhjeve. Projektligji është proceduar në versionin e njëjtë në këtë mandat andaj komisioni ka pa nevojën e trajtimit më të veçantë të tij duke ditur se ai rregullon një fushë mjaftë të ndjeshme dhe komplekse. Në vazhdim kërkoi nga z. Collins të elaburoj edhe gojarisht komentetet e tija lidhur me Projektligjin dhe amendamentet e propozuar.

Richard Collins theksoi se ka analizuar si Projektligjin po ashtu edhe amendamentet. Amendamentet e propozuara sjellin përmisime por nuk arrijnë të plotësojnë boshllëqet që ka Projektligji ashtu siç kërkohet me standardet ndërkombëtare. Ato i'u referohen strukturave institucionale që nuk do të egzistojnë në të ardhmen, si psh., atyre të UNMIK-ut. Z. Collins theksoi se duke u nisur nga përvoja në vendet e rajonit, konkretisht në Shqipëri të cilët kanë ligjin e tillë por është jo i zbatueshëm, ka propozuar që Projektligji ti kthehet hartuesit me qëllim që të hartohet një ligj që do të jetë funksional dhe i zbatueshëm për arsye se ky Projektligj nuk mundëson ndjekjen e krimit të pastrimit të parave.

Kryetari u akordua se pas 17 shkurtit kanë ndryshuar rrethanat në Kosovë e kjo është reflektuar edhe në Projektligjin në fjalë, sidomos sa i përket kompetencave të institucioneve që do të jenë përgjegjëse në luftimin e pastrimit të parave. Megjithatë duke u nisur nga parimi se asnjë Ligj nuk mund të jetë perfekt dhe nga zbrazëtira juridike që egzistojnë në këtë fushë, Komisioni ka menduar ta miratoi atë.

Haki Shatri u pajtua me mendimin e z. Collins për shtyrje të Ligjit. Propozoi që të kërkohet nga sponzoruesi që ta hartoi një draft të ri brenda një periudhe të caktuar kohore që mund të jetë një muaj dhe në hartimin e tij të kyçen ekspertët përkatës më qëllim që të miratohet një Ligj që do të ishte i zbatueshëm në praktikë.

Pas vërejtjeve dhe sugjerimeve të bëra, Komisioni me shumicë votash (një abstenim) nxori këtë:

REKOMANDIM

- I. Komisioni për Buxhet dhe Financa (në tekstin e mëtutjeshëm Komisioni) , pas shqyrtimit përfundimtar të projektligjit dhe amendamenteve të veta, dhe në konsultim dhe sugjerim të ekspertëve ndërkombëtarë nga vende respektive që kanë eksperiencën e duhur legislative dhe praktikën e luftimit të pastrimit të parasë, e vlerësoi të nevojshme tërheqjen e Projektligjit për parandalimin e pastrimit të parasë nga procedura e rregullt e shqyrtimit të mëtutjeshme në Kuvend.
- II. Komisioni i rekomandon Kuvendit që projektligji t'i kthehet propozuesit (Qeverisë) dhe në pajtim me rregullën 33. 1. e) të Rregullores së Punës së Kuvendit, me vendim të udhëzojë Qeverinë që në afat sa më të shkurtë kohor të hartojë një projektligj të ri për parandalimin e pastrimit të parasë.
Të udhëzohet hartuesi (Ministria për Ekonomi dhe Financa) që me rastin e hartimit të projektligjit të ri, të krijojë bashkëpunim të ngushtë me ekspertët e kyçur në shqyrtimin e projektligjit në komision.
- III. Komisioni në të njëjtën kohë kërkon që Kuvendi të informohet dhe deklarohet lidhur me rekomandimet e dhëna.

5. Shqyrtimi i Projektligjit për përfitimet e ish zyrtarëve të lartë me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, me amendamente

Kryetari konstatoi se Projektligji dhe amendamentet e propozuara nuk kanë implikime buxhetore. Por megjithatë Projektligji nuk rregullon drejtë çështjen, përfshin vetëm tre ish zyrtar të lartë që do të gëzonin përfitimet nga ky Ligj dhe lenë jashtë rregullatives pozitat tjera të ish zyrtarëve të lartë. Propozoi që me një ligj të veçantë të rregullohet çështja e përfitimve për të gjithë ish zyrtarët e lartë.

Haki Shatri theksoi se ekziston Ligji i veçantë për ish Presidentin dhe ish Deputetët, prandaj edhe nuk janë përfshirë këtu. Ndërsa sipas tij nuk janë të rregulluara vetëm përfitimet për ish ministrat. Z. Shatri kërkoi me amendament të bëhet harmonizimi i kompensimit të të gjithë ish zyrtarëve të lartë.

Shkumbin Demaliaj bëri vërejtje rreth ankesës së gjyqtarëve të cilët mosefikasitetin e tyre në punë e arsyetojnë në ekzistimin e zbrazëtirave ligjore, kur dihet se janë aplikuar Ligjet e aplikueshme dhe duke u bazuar në ato ligje kanë shqiptuar dënimet. Kërkoi që afati i kontratave të punësimit të gjyqëtarve të jetë i përhershëm në mënyrë që t'iu krijohen kushtet ligjore që të jenë të mbrojtur në kryerjen e detyrave të tyre konform ligjit.

Hajdin Abazi kërkoi që të miratojn ligje të zbatueshme dhe afatgjate, në mënyrë kur të hyjë Kushtetuta në fuqi të mos na detyrojë të i ndryshojmë ato.

Kryetari propozoi që të organizohet një takim i përbashkët në mes disa anëtarëve të komisionit tonë me Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësisë në mënyrë që të harmonizohen qëndrimet lidhur me Projektligjin dhe amendamentet e propozuara.

Pas vërejtjeve dhe propozimeve të bëra, Komisioni me votimin e bërë njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

- I. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Projektligjin për përfitimet e ish zyrtarëve të lartë dhe ka konstatuar se dispozitat e të njëjtit nuk përmbajnë implikime buxhetore.

- II. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, dhe ka konstatuar se amendamentet nuk përmbajnë implikime buxhetore.

Vërejtje konkrete

- III. Komisioni për Buxhet dhe Financa vlerëson se Projektligji nuk rregullon drejtë çështjen e përfitimeve të ish zyrtarëve të lartë, ngase lë jashtë rregullimit ligjor pozitat tjera të ish zyrtarëve të lartë në Kosovë.
- IV. Bazuar në të lartshënuarat, Komisioni për Buxhet dhe Financa i rekomandon Kuvendit të shtyjë miratimin e projektligjit me amendamentet e propozuara, deri në harmonizimin e qëndrimeve me komisionin funksional - Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi.

Anëtarët e caktuar për mbledhjen e përbashkët me Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi:

1. Haki Shatri
2. Kosara Nikolić
3. Besa Gaxherri
4. Hajdin Abazi
5. Xhevdet Neziraj.

6. Shqyrtimi i Projektligjit për deklarimin dhe prejardhjen e pasurisë së zyrtarëve të lartë publik me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, me amendamente

Kryetari theksoi se Projektligji dhe amendamentet e propozuara nga komisionit funksional nuk kanë implikime buxhetore dhe kërkoi nga anëtarët ta mbështesin atë.

Pasi që nuk kishte vërejtje, me votimin e bërë Komisioni njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

- I. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Projektligjin për deklarimin dhe prejardhjen e pasurisë së zyrtarëve të lartë publik dhe ka konstatuar se dispozitat e të njëjtit nuk përmbajnë implikime buxhetore.
- II. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, dhe ka konstatuar se amendamentet nuk përmbajnë implikime buxhetore.
- III. Bazuar në të lartshënuarat, Komisioni për Buxhet dhe Financa i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara

7. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, me Penale amendamente

Kryetari theksoi se Projektligji dhe amendamentet e propozuara nga komisionit funksional nuk kanë implikime buxhetore dhe kërkoi nga anëtarët ta mbështesin atë.

Pasi që nuk kishte vërejtje, Komisioni me votimin e bërë njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

- I. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale dhe ka konstatuar se dispozitat e të njëjtit nuk përmbajnë implikime buxhetore.
- II. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, dhe ka konstatuar se amendamentet nuk përmbajnë implikime buxhetore.
- III. Bazuar në të lartshënuarat, Komisioni për Buxhet dhe Financa i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

8. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, me amendamente

Beasa Gaxherri bëri vërejtje që i është ndërpre fjala. Kërkoj që të bëhet një amendament në Projektligjin në fjalë në mënyrë që të fshihet fjala i Përkohshëm dhe Komisioni t'i rekomandoj Kuvendit për ndryshim.

Armend Zemaj theksoi se të gjitha ligjet e miratuara kanë bazën në Kornizën Kushtetuese mbeten si të tilla deri sa të hyjë Kushtetua në fuqi.

Shkumbin Demaliaj u pajtua me znj. Gaxherri që të fshihet fjala e Përkohshme dhe të mos krahasohen Ligjet që miratojmë tani me ato të kaluara duke pasur parasysh faktin se kompetenca e institucioneve ka ndryshuar dhe kushtetua është miratuar.

Pasi vërejtje dhe propozimeve, me votimin e bërë Komisioni me shumicë votash (tetë pro, dy kundër-znj. Gaxherri dhe z. Demaliaj dhe asnjë abstenim) nxori këtë:

REKOMANDIM

- I. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale dhe ka konstatuar se dispozitat e të njëjtit nuk përmbajnë implikime buxhetore.
- II. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, dhe ka konstatuar se amendamentet nuk përmbajnë implikime buxhetore.
- III. Bazuar në të lartshënuarat, Komisioni për Buxhet dhe Financa i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

9. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 03/L-18 për Provimin përfundimtar dhe të maturës me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sporte, me amendamente

Armend Zemaj theksoi se ka dhënë vërejtje dhe amendamentet e tij dhe se amendamentet e propozuara nuk kanë implikime buxhetore.

Pasi që nuk kishte vërejtje, Komisioni me votimin e bërë njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

- I. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Projektligjin për Provimin përfundimtar dhe të maturës dhe ka konstatuar se dispozitat e të njëjtit nuk përmbajnë implikime buxhetore.
- II. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sporte, dhe ka konstatuar se amendamentet nuk përmbajnë implikime buxhetore.
- III. Bazuar në të lartshënuarat, Komisioni për Buxhet dhe Financa i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

10. Të ndryshme

Kryetari kërkoi nga grupi punues i caktuar me vendim për të bërë propozimet për kompensimin e deputetëve të filloj punën dhe brenda afatit të paraqes raportin me rekomandime pranë Komisionit.

Mbledhja përfundoi në ora 15:05

Shërbimi i komisioneve

Kryetari i Komisionit

Gani KOCI